



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 355/5 Prot.

Tiranë, më 18.04.2017

V E N D I M

Nr.85, datë 18/04/2017

“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.91, datë 25.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 355 prot., datë 22.04.2016”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 91, datë 25.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 355 prot., datë 22.04.2016”, në institucionin e Bashkisë Mat,

VËREJ SE:

Me Urdhrin nr. 355, datë 22.04.2016, “Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit në shërbimin civil në Bashkinë Mat”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar inspektimi në lidhje me ligjshmërinë e rekrutimeve në Bashkinë Mat. Bazuar në këtë urdhër ka vijuar inspektimi në institucionin e mësipërm. Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.91, datë 25.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.355., prot, datë 22.04.2016”, në të cilin është vendosur:

1. Fillimisht, njësia përgjegjëse duhet të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse, të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës, sipas përkufizimit të përcaktuar në nenin, 4/1/c të ligjit, nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke përjashtuar rastet e përcaktuara në nenin 2, të këtij ligji. Ky proces duhet të materializohet në strukturën e institucionit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Vendimin, nr. 70, datë 22.02.2016, duke u specifikuar në mënyrë të shprehur në këtë akt administrativ, pozicioni në shërbimin civil.

2. Njësia përgjegjëse, duhet të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në shërbim civil për punonjësit, që rezultojnë se i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
3. Pas përfundimit të procesit të deklarimit të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve të punës të zëna në kundërshtim me ligjin, duhet të ndjekë këtë rend veprimesh:

Së pari, të verifikojë nëse ndonjë prej punonjësve, nga 8 (tetë) ish-Komunat apo ish-Bashkia Burrel (aktualisht Bashkia Mat), të cilët kanë qenë të punësuar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për shërbimin civil”, i ndryshuar dhe që në kuptim të nenit 67, pika 3, të këtij ligji, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, i plotësojnë kërkesat për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira, dhe të kryejë emërimet pa konkurrim në atë pozicion.

Së dyti, të verifikojë listën e punonjësve të liruar nga shërbimi civil, pas ristrukturimit të institucionit dhe nëse ndonjë prej tyre plotëson kërkesat e vendit të punës, për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira, të emërohet në atë pozicion, pa konkurrim.

Së treti, pasi të ketë ezauruar dy hapat e parë, të shpallë procedurat e konkurrimit për pozicionet që do të rezultojnë ende të lira.

4. Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2016, planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga përfaqësuesit e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
5. Njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktet administrative që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm të 4 punonjësve, si më poshtë:
 - Aktin nr.147, datë 05.04.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “Specialist veteriner”.
 - Aktin nr.212, date 14.12.2015, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicion “Përgjegjës i zyrës së bujqësisë”.
 - Aktin nr. 93, datë 13.10.2015, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “Përgjegjës i zyrës së shërbimeve”.
 - Aktin nr. 46, datë 20.01.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “Specialist arkitekt urbanist”.
6. Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil, pasi të jetë respektuar rendi i veprimeve të përcaktuara më sipër.

7. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të respektojë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

Në veçanti, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- ✓ Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimi dhe vlerësimit (Komiteti i Përhershëm i Pranimi për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
- ✓ Të bëjë publik në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Mat, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet që kërkohen nga ligji dhe aktet nën ligjore, për të materializuar procedurat e rekrutimit, të tilla si:
 - Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimi (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.
 - Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.
 - Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.
 - Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

8. *Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mat, të zbatojë vendimin brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative që janë kryer, për zbatimin e këtij vendimi.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar nr. 91, datë 25.07.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Bashkisë Mat, prej datës 28.04.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me Vendimin nr. 16, datë 09.02.2017, *“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 91, datë 25.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Bashkisë Mat, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 28.04.2016 e në vazhdim”,* ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 91, datë 25.07.2016, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.355., prot, datë 22.04.2016”.*

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Mat dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 91/2 prot., datë 09.02.2017 *“Njoftim për fillimin e verifikimit”.*

Bazuar në procesverbalin e datës 20.02.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe nënshkruar edhe nga personat e kontaktit të institucionit të Bashkisë Mat dhe pas shqyrtimit të materialeve shkresore të administruara në përfundim të procesit të verifikimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në pikën 1 të Vendimit Nr.91, dt.25.7.2016, ka kërkuar përcaktimin e pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj dhe materializimin e këtij procesi në strukturën e këtij institucioni. Njësia përgjegjëse në zbatim të pikës 1 të vendimit të mësipërm ka përcaktuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në strukturën aktuale të institucionit, duke u bazuar në detyrat konkrete të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës për çdo punonjës (*kopje e strukturës bashkëngjitur shkresës nr.1981/1, dt.7.9.2016*).
- Në zbatim të pikës 2 të vendimit, njësia përgjegjëse pasi më parë ka verifikuar dosjet e punonjësve që punojnë në pozicione pune në shërbimin civil, në zbatim të rekomandimit të Komisionerit, si dhe bazuar në nenin 67 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ka deklaruar statusin e punësimit për punonjësit:
 1. ***** është deklaruar *“Nëpunëse civile”* me aktin nr.622, dt.24.03.2016, në pozicionin *“Specialiste e Turizmit”*;
 2. ***** është deklaruar *“Nëpunëse civile”* me aktin nr.1778, dt.08.07.2016, në pozicionin *“Specialiste e Urbanistikës”*;
 3. ***** është deklaruar *“Nëpunës civil”* me aktin nr.623, dt.24.03.2016, në pozicionin *“Specialist i Zyrës së Taksave”*.

Nga verifikimi i akteve në dosjet e personelit të këtyre punonjësve, të administruara edhe nga grupi i punës gjatë procesit të verifikimit në subjekt, rezulton se njësia e burimeve njerëzore

të institucionit ka vepruar drejt kur ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civilë për këta punonjës, pasi ata i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të posaçme që kërkohen nga ligji.

- Njësia përgjegjëse, në zbatim të rekomandimit të pikës 3 të vendimit të Komisionerit, për plotësimin e 4 pozicioneve të punës të zëna në kundërshtim me ligjin, ka vepruar sipas rendit të përcaktuar në vendim. Pasi ka verifikuar dosjet e punonjësve që kanë punuar në 8 (tetë) ish-komunat e Bashkisë Mat ka konstatuar se vetëm dy prej tyre plotësonin kriteret e kërkuara nga ligji për shërbimin civil dhe i ka emëruar ata pa konkurrim si nëpunës civilë në po ato pozicione pune që kanë pasur. Konkretisht, i është bërë deklarami i statusit të punësimit nr. 2298, datë 05.09.2016, punonjësit ***** në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë*” në Njësinë Administrative Ulëz dhe i është bërë deklarami i statusit të punësimit nr. 2299, datë 05.09.2016, punonjësit ***** në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë*” në Njësinë Administrative Rukaj. Për plotësimin e 2 pozicioneve të tjera të punës, njësia përgjegjëse ka shpallur procedurat e konkurrimit, të cilat do të përshkruhen më hollësisht në pikat e mëposhtme të këtij relacioni.
- Në zbatim të pikës 4 të vendimit, njësia përgjegjëse, me shkresat nr. Ekstra, datë 25.07.2016 dhe 20.02.2017, ka hartuar planet e punës “*Mbi pranimet në shërbimin civil*” për vitin 2016 dhe 2017. Në planet e punës janë përfshirë të gjitha pozicionet e punës që realisht janë të lira në strukturën organizative të miratuar me Vendimin nr.70, datë 22.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Mat, si dhe ato që janë zënë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Në lidhje me revokimin e akteve për emërimin e përkohshëm të 4 punonjësve, të dala në kundërshtim me ligjin, detyrë e cila i është lënë njësisë përgjegjëse të institucionit në pikën 5 të vendimit, rezulton se nga ana e kësaj njësie janë kryer veprimet e mëposhtme:
 1. Punonjësi ***** , emëruar me aktin administrativ nr.147, datë 05.04.2016, në detyrën “*Specialist veteriner*”, është emëruar “*Specialist*” në Agjensinë e Pyjeve dhe Vaditjes, pozicion ky që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil e për rrjedhojë pozicioni “*Specialist veteriner*”, rezulton i lirë.
 2. Punonjësi ***** ka konkurruar për pozicionin “*Drejtor i Politikave të Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Pyjeve*” dhe pas përfundimit të konkurrimit është emëruar në pozicionin e mësipërm me aktin administrativ nr.34, datë 30.01.2017 (*praktika e konkurrimit është administruar në dosjen përkatëse të verifikimit*).

Pozicioni i punës që ka pasur nëpunësi më parë “*Përgjegjës i Zyrës së Bujqësisë*” është shpallur i lirë.

 3. Pozicioni i punës “*Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve*” që mbante punonjësi ***** , në strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 70/1, datë 22.07.2016 nuk ekziston më. Rezulton se zyra është ristrukturuar në drejtori dhe pozicioni i punës “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Bashkiake* ” është shpallur i lirë si në faqen e Bashkisë Mat dhe në institucionin, Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

4. Pozicioni i punës “*Specialist i Urbanistikës*”, i mbajtur nga punonjësi ***** , emëruar në këtë pozicion me aktin e emërimit nr.46, datë 20.01.2016, është shpallur i lirë me shkresën nr. Ekstra, datë 20.02.2017.

Sa më sipër, nuk materializon zbatimin korrekt të kësaj pike të vendimit, pasi referuar pikës 1 të nenit 124 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili ishte në fuqi në momentin e verifikimit dhe daljes së vendimit të Komisionerit: “... e drejta për të revokuar aktin i takon organit që e ka nxjerrë atë...”. Sipas nenit 125 të këtij ligji, “... akti revokues ... ka të njëjtën formë ligjore dhe ndjek të njëjtat procedura me aktin që revokohet...”. Megjithatë, duke pasur parasysh se:

- punonjësi ***** , aktualisht është i emëruar në një pozicion pune jashtë shërbimit civil;
- për punonjësin ***** është kryer procedura e konkurrimit dhe është emëruar në pozicionin “*drejtor i politikave të zhvillimit ekonomik, bujqësisë dhe pyjeve*” në përputhje me ligjin;
- pozicioni i punës “*përgjegjës i zyrës së shërbimeve*” , me strukturën e re është ristrukturuar dhe është emërtuar “*drejtor i drejtorisë së shërbimeve bashkiake*”;
- pozicionet e punës që mbaheshin nga punonjësit ***** , ***** dhe ***** janë shpallur të lira;

çmohet se kjo pikë e vendimit duhet të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen njësisë përgjegjëse që në të ardhmen të ndjekë në mënyrë rigorozë përcaktimet e ligjit.

- Në lidhje me plotësimin e pozicioneve të lira nëpërmjet procedurës së konkurrimit, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse është zhvilluar procedura e konkurrimit për pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Pyjeve*”. Pas verifikimit të kësaj procedure, grupi i punës arriti në përfundimin se nga ana e njësisë përgjegjëse janë zbatuar përcaktimet e nenit 22 dhe 25 e vijues të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*” dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”, të Departamentit të Administratës Publike.
- Në zbatim të rekomandimit të pikës 7 të vendimit të Komisionerit, me Urdhrin nr.3, datë 04.01.2017, është krijuar “*Komiteti i Pranimit për ngritjen në detyrë*” dhe me Urdhrin nr.616, datë 10.10.2016 është krijuar “*Komiteti i përhershëm i pranimit në kategorinë ekzekutive*”.

Janë bërë publike në faqen zyrtare, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” shpalljet që kërkohen nga ligji dhe aktet nënligjore për procedurat e rekrutimit e konkretisht:

- Akti i shpalljes për plotësimin e një pozicioni të lirë të punës në shërbimin civil, të administruar nga grupi i punës. Akti përmban të dhënat e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidatëve; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.
- Akti i shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*”, ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
- Akti i shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*”, ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
- Akti i shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

Zbatimi i rekomandimit të pikës 7, vërtetohet nga praktika e plotë e konkurrimit për pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Pyjeve*”, e cila është administruar si provë shkresore nga grupi i punës.

Për sa u përket më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 91, datë 25.07.2016, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 355 prot., datë 22.04.2016*”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Mat janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmëruar.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” dhe nenin 34 të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr. 91, datë 25.07.2016, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 355 prot., datë 22.04.2016*”, të Komisionerit, në institucionin e Bashkisë Mat.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Mat, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 91, datë 25.07.2016, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 355 prot., datë 22.04.2016”*.
3. Për këtë vendim të njoftohet i Kryetari i Bashkisë Mat dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA